

TË DREJTAT

DETYRIMET

TË DREJTAT E DETYRIMET

gjatë një kontrolli policor

Realizuar nga shërbimi i kohezionit multikulturor
dhe policia e Neuchâtel-it

Themelet demokratike

Themelet, qëllimet dhe fushat e veprimtarisë së policisë janë të përcaktuara nga Kushtetuta, ligjet federale dhe kantonale si dhe nga konventat ndërkombëtare. Autoritetet kantonale administrojnë policinë e tyre, ndërkohë që Policia federale (fedpol) ndërhyt në çështjet kombëtare.

E vendosur nën mbikëqyrjen e autoriteteve, **policia zbaton ligjin duke respektuar të drejtat themelore dhe garancitë kushtetuese**. Në rrethana të caktuara të parashikuara nga ligji, forcat e policisë mund të jenë të detyruara të kufizojnë disa nga të drejtat dhe liritë.

Qëllimi i kësaj broshure është të informojë mbi të drejtat dhe detyrimet gjatë një kontrolli, për të favorizuar një klimë respekti dhe qetësie reciproke.

Misioni i policisë

Misioni i policisë është të sigurojë sundimin e ligjit duke garantuar sigurinë publike, duke ruajtur rendin dhe respektimin e ligjeve. Ajo vepron sipas parimeve të shembullit, të proporcionalitetit dhe të paanshmërisë. Kontrollat e identitetit janë pjesë e prerogativave të saj.

Kontrolli policor

Vetëm oficerët-et e policisë dhe doganierët-et janë të autorizuar-a të kryejnë kontrolle policore.

Ja hapat kryesorë që ata mund të ndërmarrin:

- **Kontroll identiteti:** ju duhet të jepni emrin, mbiemrin, datëlindjen, adresën, profesionin dhe emrat e prindërve. Nëse nuk keni një dokument identifikimi, mund të kërkohen dokumente të tjera ose masa identifikimi për të përcaktuar identitetin tuaj. Agjentët e sigurisë publike mund të kryejnë gjithashtu një kontroll identiteti.
- **Transport për në stacionin e policisë:** ju mund të shoqëroheni për në stacionin e policisë në rast dyshimi të një veprë penale. Paraburgimi kufizohet në 24 orë, përveç rasteve kur mund të zgjaset nga prokurori ose gjyqtari.
- **Kontroll:** rrobat, bagazhet ose automjetet tuaja mund të kontrollohen. Kontrollët e pjesëve intime duhet të kryhen nga një person i të njëjtit seks ose nga një mjek, përveç rasteve të urgjencës. Një kontroll në publik duhet të përfshijë vetëm inspektime të vogla (p.sh.: prekje mbi rroba), duke respektuar dinjitetin e personit.
- **Telefoni celular:** policia mund të sekuestrojë një telefon për hetim, por qasja në përmbajtjen e tij kërkon lejen e pronarit-es të tij ose një urdhër gjykatë.
- **Përdorimi i forcës:** përdorimi i forcës justifikohet vetëm nëse rezistenca e personit përbën pengesë për ekzekutimin legjitim të një misioni, siç është arrestimi ose marrja në pyetje, por edhe në rastin kur duhen mbrojtur të tjerët.
- **Prangat:** përdoren vetëm në rast rreziku për veten ose të tjerët, ose në rast rreziku arratisjeje.
- **Vendosja në qeli:** vendosje e përkohshme për prishje të rendit publik, rrezik eminent, rrezik arratisjeje, bashkëpunim ose përsëritje të veprës penale.

Të drejtat tuaja gjatë një kontrolli policor

1. E drejta për të heshtur

- Nuk jeni të detyruar t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve përveç atyre që kanë të bëjnë me identitetin tuaj. Mund të përgjigjeni: « Unë nuk jap deklaratë. »

2. E drejta për një avokat-e

- Nëse arrestoheni, keni të drejtë të konsultoheni me një avokat-e që në fillim të procedurës, eventualisht me shpenzimet tuaja.

3. Të drejtat mbi sendet tuaja personale

- Policia mund të sekuestrojë telefonin tuaj, por nuk mund të hyjë në përmbajtjen e tij pa lejen tuaj ose të një autoriteti ligjzbatues.
- Nuk jeni i detyruar të jepni kodin tuaj pa urdhërin e një gjyqtari-eje.

4. E drejta e mosushtrimit të një kontrolli të pajustificuar

- Një kontroll duhet të justifikohet nga arsyet ligjore (p.sh. për sigurinë, dyshimin për një krim ose shkelje).

5. Mbrojtje kundër abuzimit

- Ju keni të drejtë për një trajtim me respekt, pa diskriminim apo dhunë të tepruar.

6. Specifikimet për të miturit-at

- Nëse jeni i/e mitur, përfaqësuesit tuaj ligjorë duhet të informohen në rast arrestimi ose sekuestrimi të pronës.

Detyrimet tuaja gjatë një kontrolli policor

1. Të jepni të dhënat tuaja personale

- Mbiemrin, emrin, datëlindjen, adresën.
- Refuzimi ose dhënia e informacionit të rremë mund të ketë masë ndëshkimore.

2. Ndiqni udhëzimet

- Ju duhet të ndiqni udhëzimet e agjentëve të policisë për të garantuar sigurinë.
- Nëse mendoni se kontrolli është i pajustificuar, mund ta kundërshtoni më vonë atë.

3. Respekt dhe qëndrim i përgjegjshëm

- Silluni në mënyrë të respektueshme.
- Shmangni çdo lëvizje të papritur që mund të keqinterpretohet.

4. Detyrim për të qëndruar në vend

- Nëse policia ju kërkon të mos largoheni nga vendi ku ndodheni, duhet ta respektoni këtë udhëzim.

5. Mos e pengoni ndërhyrjen e policisë

- Mos ndërhyjni në hetim dhe mos i fshihni informacionet.

Çfarë duhet të bëni në rast mosmarrëveshje?

1. Merrni shënime

- Shënoni emrat, numrat e regjistrimit, datën, orën dhe vendin e kontrollit.
- Dokumentoni çdo sjellje ose fjalë problematike.
- Identifikoni dëshmitarët dhe mblidhni të dhënat e tyre të kontaktit.

2. Kërkoni këshilla juridike

- Konsultohuni me një avokat ose me një shoqatë për të drejtat e njeriut.
- Kontaktoni Shërbimin e Kohezionit Multikulturor (COSM) për çdo ndihmë dhe/ose mbështetje.

3. Bëni një padi

- Adresoheni padinë tuaj në strukturat e policisë, në Prokurorinë Publike ose në COSM nëse mendoni se jeni diskriminuar, në rast sjelljeje abuzive, në mungesë të një arsyeje objektive, në rast kontrollesh të përsëritura pa ndonjë arsye të vlefshme.

Për një konsultim ose një raportim në shërbimin e kohezionit multikulturor :

Zyra e konsultimit

Konsultimet ofrohen për këdo që është viktimë ose dëshmitar i racizmit dhe/ose diskriminimi, pavarësisht nga statusi i tyre i qëndrimit. Konsultimet janë falas dhe konfidenciale, me një përkthyes-e, nëse është e nevojshme.

Zyra e ankesave

Shërbimi i kohezionit multikulturor është ngarkuar të presë, të informojë dhe të mbështesë njerëzit që dëshirojnë të ngrenë një padi penale kundër zyrtarëve publikë për akte që lidhen me diskriminimin, me racizmin ose me dhunën.

Raportimet mund të bëhen nëpërmjet internetit, në sportel ose me email.

Orari i sporteleve

La Chaux-de-Fonds

Place de la Gare 6

Tel. 032 889 74 42

Email : cosm@ne.ch

Nga e hëna deri të premten : 8:00-12:00 dhe 13:30-17:00

Neuchâtel

Tivoli 22

Nga e hëna në të enjten : 14:00-17:00 ose me takim

Fleurier

Rue du Temple 8

Të hënë : 14:00-17:00 ose me takim



© Sarah Zaffferri

Dokumente referuese

- Kodi zviceran i procedurës penale (CPP)
- Kodi penal zviceran (CP)
- Ligji mbi policinë e kantonit të Neuchâtel-it (LPol)
- Ligji mbi integrimin dhe kohezionin multikulturor (LICM)